



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 25, datë 28.04.2015

MBI

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AUTORITETIT TË
MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare“, të ndryshuar, nenit 4, 7 dhe 10, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen drejtoritë përkatëse sipas tabelës së Programit të Transparencës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

Programi i Transparencës për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Miratur me Vendimin e Bordit nr. 25, datë 28.04.2015

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së Autoritetit në kuadër të Ligjit nr. 9572, date 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtej e tutje AMF) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e Ligjit për të Drejtën e Informimit. AMF do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2, të nenit 5, të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AMF-se, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare www.amf.gov.al. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AMF-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që

karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AMF-së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: AMF ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AMF-së dhe përkatësisht: Ligji nr. 9572, date 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të AMF-së.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AMF vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.amf.gov.al kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të AMF-së;

- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;

- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të AMF-së, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;

- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të AMF-së dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi AMF-në, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

- Informacion për procedurat e prokurimit sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të AMF-së, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

- Informacion për shërbimet që AMF i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga AMF;

- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e AMF-së, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AMF-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor AMF për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me postimin në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Bordi i AMF-së.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/ Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Miratuar me Vendim Bordi Struktura e AMF-së	Pas miratimit nga Bordi		Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme
Akte ndërkombëtare ligje; akte nënligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Konventa Ligje Akte Nënligjore Kodi i Etikës Dokument Politikash	Pas botimit në fletoren zyrtare Miratuar me Vendim Bordi nr. 119, datë 19.09.2011	Në faqen zyrtare në menunë "Kudri Ligjor"	Departamenti i Çështjeve Juridike Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme/ Departamenti i Çështjeve Juridike Kabineti
Informacion për	Neni	Format kërkesë	Pas miratimit të Programit të		Koordinatori

<p>procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.</p>	<p>7/1/c/g</p>	<p>Format përgjigje</p> <p>Format ankese</p> <p>Format për refuzim kërkesë</p> <p>Format për zgjatje afati</p> <p>Format për rishikimin e dokumenteve të klasifikuara dhe shtyrjen e afatit</p> <p>Adresë postare Adresë e-maili</p>	<p>Transparencës Menjëherë në rast ndryshimesh</p>	<p>Në faqen zyrtare në menunë "Kontakttoni"</p>	
<p>Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.</p>	<p>Neni 7/1/ç</p>		<p>Sipas urdhrnit të caktimit të Koordinatorit</p>	<p>Në faqen zyrtare në menunë "Kontakttoni"</p> <p>Në faqen zyrtare në menunë "AMF - E Drejta e Informimit - Koordinatorit"</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme</p> <p>Koordinatori</p>
<p>Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.</p>	<p>Neni 7/1/d</p>	<p>Vendim Kuvendi</p> <p>Parashikimet ligjore: a) Nenet 4-18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar; b) Rregullore për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit të AMF-së</p>		<p>Në faqen zyrtare në menunë "AMF-Bordi AMF"</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme</p> <p>Departamenti i Çështjeve Juridike</p>

Mekanizmat monitorues; raporte auditit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raporte monitorimi dhe auditimi Plani strategjik 2015-2019 i Auditimit të Brendshëm Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë	Menjêherë pas depozitimit në AMF Pas miratimit nga Bordi Menjêherë pas depozitimit në AMF		Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme Auditi i Brendshëm Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës
Buxheti	Neni 7/1/e	Buxheti Raport Vjetor	Pas miratimit nga Bordi Menjêherë pas depozitimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë në AMF	Në faqen zyrtare në menunë "Statistika dhe Publikime - Publikime - Raport Vjetor"	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Regjistri i Realizimeve dhe i Shtesave	Përditësohet çdo 4 (katër) muaj		Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Verifikoni policën tuaj te sigurimit të detyrueshëm motorik Trajtim i ankesave të konsumatorëve Numri Jeshil pa pagesë		Në faqen zyrtare në menunë "Verifikoni policën tuaj te sigurimit të detyrueshëm motorik" Në faqen zyrtare në menunë " Trajtim i ankesave të konsumatorëve" Në faqen zyrtare në menunë "Mbrojtja e Konsumatorit"	Drejtoria e Zbatueshmërisë
Paraqitja e mendimeve në	Neni 7/1/gj	Projekt Akte	Pas përfundimit të hartimit të	Në faqen zyrtare në menunë "Kudri	Departamenti i Çështjeve Juridike

hartimin e p/akteve, etj.			p/aktit	Ligjor-Projekte në Proces"	
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/1/h	Protokoll /Arkiva	Pas miratimit të rregullores së Brendshme të funksionimit të AMF-së		Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij Ligjit nr. 119/2014.	Neni 7/1/i	Tabelë	Pas miratimit nga Bordi të "Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në menunë "AMF-E Drejta e Informimit-Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve"	Koordinatori
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Kuadri Ligjor Statistika dhe Publikime Subjekte nën Juridiksion		Në faqen zyrtare në menunë "Kuadri Ligjor" Në faqen zyrtare në menunë "Statistika dhe Publikime"	Departamenti i Çështjeve Juridike Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Historiku, misioni, objektivat Bashkëpunimi Institucional Edukimi i Publikut Instruksione dhe Formularë		Në faqen zyrtare në menunë "AMF-Përshkrim i shkurtër" Në faqen zyrtare në menunë "AMF - Bashkëpunimi Institucional" Në faqen zyrtare në menunë kryesore Në faqen zyrtare në menunë "Subjekte nën Juridiksion - Instruksione dhe Formularë"	AMF Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit / Drejtoria e Zbatueshmërisë

Regjistri i ankesave dhe kërkesave

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
1				Përfunduar	Nuk ka
2				Përfunduar	Nuk ka
3			Fotokopje e dokumentacionit të kërkuar	Përfunduar	Nuk ka
4				Përfunduar	Nuk ka